

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE TIRANË**

**RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR  
(Raport i Fakteve të Gjetura)**

---

**Mbi Auditimin Ligjor të  
Fondeve të Përftuara dhe të Shpenzuara  
Gjatë vitit kalendarik 2011  
nga  
“Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të  
Punëtoreve të Shqipërisë (P.M.D.P.SH)”**

**Eleonora OLLI  
Eksperte Kontabel e Regjistruar  
04/06/2012**

**1**

**RAPORT I FAKTEVE TE GJETURA date 04.06.2012  
Partia per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise (P.M.D.P.SH)**

**Eleonora OLLI  
Eksperte Kontabel e Regjistruar (Autorizuar), Liçensë Nr. 114, Date 05.04.2006,  
NIPT L113130080, Rr. "Ismail Qemal", Pall. "GENER 2", Zyra Nr. 3, Tirane  
Tel/Fax +355 4 22 57 047, Cel. 0674068500, e-mail:eleonoratelo@yahoo.com, teloauditing@yahoo.com**

**R A P O R T**  
**I**  
**FAKTEVE TE GJETURA**

**Për : KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**T I R A N Ë**

Ne kemi kryer procedurat e rena dakort me ju ne kontraten e lidhur ndermjet paleve ne date 24.05.2012 qe do te pershkruhen me poshte, lidhur me fondet e perftuara dhe te shpenzuara gjate vitit 2011 nga "Partia per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise" (P.M.D.P.SH).

Angazhimi yne u krye ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit dhe ne veçanti me SNA 4400 te zbatueshem ne angazhimet per procedurat e rena dakort.

Procedurat u kryen vetem per t'ju ndihmuar juve qe te percaktoni fondet e perftuara dhe te shpenzuara gjate vitit 2011 nga "Partia per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise" (P.M.D.P.SH) te cilat jane permbledhur me poshte :

1.Ne morem nga KQZ Vendimin Nr. 6 date 04.04.2012 per kryerjen e auditimit ligjor te fondeve te perftuara dhe te shpenzuara ne vitin 2011 nga "Partia per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise" (P.M.D.P.SH).

2.Ne morem nga KQZ numrin dhe daten e vendimit te gjykates me te cilen ishte rregjistruar "Partia per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise" (P.M.D.P.SH).

3.Në

baze te vendimit Nr. 6 date 04.04.2012 te KQZ ne ju drejtuam Gjykates se Rrethit Tirane me kerkese per te na pajisur me kopje te vendimit te rregjistrimit te "Partise per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise" (P.M.D.P.SH) per te mundesuar identifikimin e selise qendrore dhe drejtuesve te saj ne menyre qe te arrinim ne realizimin e objektit te kontrates se auditimit date 24.05.2012.

4.Ne shkuam ne seline qendrore te "Partise per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise" (P.M.D.P.SH) te deklaruar ne vendimin e gjykates Tirane ne adresen

2

RAPORT I FAKTEVE TE GJETURA date 04.06.2012  
Partia per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise (P.M.D.P.SH)

Eleonora OLLI  
Eksperte Kontabel e Regjistruar (Autorizuar), Liçensë Nr. 114, Date 05.04.2006,  
NIPT L113130080, Rr. "Ismail Qemali", Pall. "GENER 2", Zyra Nr. 3, Tirane  
Tel/Fax +355 4 22 67 047, Cel. 0674068500, e-mail:eleonoratelo@yahoo.com, teloauditing@yahoo.com

Rruga "Abdi Toptani", Nr. 4, per te kontaktuar me Organet drejtuese te partise per realizimin e auditimit ligjor te fondeve te saj.

5.Ne u interesuam dhe pyetem fqinjët qe ndodheshin ne te dy krahet e adreses se selise qendrore te partise ne Rruga "Abdi Toptani", Nr. 4., Tirane qe kufizohej nga dy Bar-Kafe ne te majte (RUBIN) dhe ne te djathte (SARAJET) per te na ndihmuar ne dhenien e informacioneve per gjetjen e kontakteve (telefon fiks ose celular, adrese banim shtepie ose e-mail) te drejtuesve te partise dhe ne veçanti te kryetarit te saj Kadri Isufaj.

6.Ne u interesuam edhe pyetem per te gjetur adresen e selise qendrore te "Partise per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise" (P.M.D.P.SH) edhe prane selise se partise demokristiane qe ndodhej perkarshi adreses se deklaruar te saj ne vendimin e gjykates.

7.Ne u interesuam dhe derguam mesazh ne facebook - un e kryetarit te partise Kadri Isufaj per te mundesuar realizimin e objektit te kontrates se auditimit.

8.Ne u takuam ne date 04.06.2012 me kryetarin Kadri Isufaj te zyren e "Partise per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise" (P.M.D.P.SH) i cili na kontaktoi mbas leximit te mesazhit tone ne facebook-un e tij.

Ne raportojme gjetjet tona si me poshte :

Ne lidhje me piken 3 ne gjetem se : "Partia per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise" (P.M.D.P.SH) eshte e rregjistruar ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane , me Nr. 3811 Akti, Nr. 2489 Vendimi, Date 10.06.2002, me Seli Qendrore ne kryeqytetin e Shqiperise Tirane ne adresen Rruga "Abdi Toptani", Nr. 4 me kryetar Kadri Isufaj.

Ne lidhje me piken 4 – 7 ne gjetem se : Selia qendrore e "Partise per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise" (P.M.D.P.SH) ishte ne Rrugen "George W Bush" ish "Punetoret e Rilindjes", Nr. 54/1, Kutia Postare Nr.7427 , Tirane.

Ne lidhje me piken 8, ne gjetem se : "Partia per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise" (P.M.D.P.SH) sipas deklarates se kryetarit zotit Kadri Isufaj nuk kishte perftuar fonde ne vitin 2011 nga buxheti i Qeverise Shqiptare .

Fondet e shpenzuara gjate vitit 2011 ishin kontribut personal i kryetarit Kadri Isufaj vetem per pagese qera zyre te Selise Qendrore te partise ne total 84 000 leke ( 12 muaj x 7 000 leke per çdo muaj ) sipas Mandat pagesave te bera ne favor te administratorit te godines se zyres Z.Bajram NELAJ.

3

RAPORT I FAKTEVE TE GJETURA date 04.06.2012  
Partia per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise (P.M.D.P.SH)

Eleonora OLLI  
Eksperte Kontabel e Regjistruar (Autorizuar), Liçensë Nr. 114, Date 05.04.2006,  
NIPT L113130080, Rr. "Ismail Qemali", Pall. "GENER 2", Zyra Nr. 3, Tirane  
Tel/Fax +355 4 22 57 047, Cel. 0674068500, e-mail:eleonoratelo@yahoo.com, teloauditing@yahoo.com

Siapas deklarimit te kryetarit Kadri Isufaj "Partia per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise" (P.M.D.P.SH) nuk kishte pergatitur Pasqyra Financiare ( Bilanc) per fondet e perftuara dhe te shpenzuara ne vitin 2011.

Si konkluzion per shkak se procedurat e mesiperme nuk perbejne auditim dhe as rishikim te bere ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit ne nuk mund te shprehim asnje opinion per fondet e perftuara dhe te shpenzuara gjate vitit 2011 nga "Partia per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise" (P.M.D.P.SH).

Nese do te kishim kryer procedura shtese ose nese do te kishim bere auditim te Pasqyrave Financiare te vitit 2011 nga "Partia per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise" (P.M.D.P.SH), (Fondeve te perftuara dhe te shpenzuara) ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit ceshtje te tjera do te kishin terhequr vemendjen tone per te cilat do tju kishim raportuar.

Raporti yne sherben vetem per qellimin e parashtuar ne paragrafin e pare te tij dhe vetem per t'ju informuar juve.

Ky raport nuk mund te perdoret per qellim tjeter dhe as t'ju shperndahet paleve te treta.

Ky raport lidhet vetem me gjetjet e raportuara me siper dhe nuk shtrihet mbi Pasqyrat Financiare te vitit 2011 (Fondet e perftuara dhe te shpenzuara) te "Partise per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise" (P.M.D.P.SH).

#### **Eksperte Kontabel e Regjistruar (Autorizuar )**

**Eleonora OLLI**



4

RAPORT I FAKTEVE TE GJETURA date 04.06.2012  
Partia per Mbrojtjen e te Drejtave te Punetoreve te Shqiperise (P.M.D.P.SH)

Eleonora OLLI  
Eksperte Kontabel e Regjistruar (Autorizuar), Liçensë Nr. 114, Date 05.04.2006,  
NIPT L11313008O, Rr. "Ismail Qemali", Pall. "GENER 2", Zyra Nr. 3, Tirane  
Tel/Fax +355 4 22 57 047, Cel. 0674068500, e-mail:eleonoratelo@yahoo.com, teloauditing@yahoo.com